

STATUT

SHOQERIA "LA BONTA" sh.p.k

KREU I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia

Neni 1

Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit

1.1 Sot ne daten 10.09.2024 ne, themeluesit, kemi krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin Shoqeria " LA BONTA " sh.p.k

1.2 Themeluesit e shoqerise jane:

-Arber Cela Shtetas Shqipetar me ID I71106072A lindur ne Lushnje dhe banues ne Lushnje.

Neni 2

Objekti i Veprimtarise

Sherbim Shperndarje

Neni 3

Kohezgjatja e Veprimtarise

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise eshte e pakufizuar.

Neni 4

Selia

4.1 Selia zyrtare e Shoqerise ndodhet ne adresen "Lagja Loni Dhamo,Shetitorja e Palmave,Nr.1/231, Lushnje".

4.2 Gjate ushtrimit te aktivitetit te saj, Shoqeria mund te hape dege dhe zyra perfaqesimi kudo ne territorin e Republikes se Shqiperise.

4.3 Adresa e Shoqerise per qellim te komunikimeve elektronike eshte : arbercela06@outlook.it

Neni 5

Regjimi Juridik i Shoqerise

5.1 Kjo shoqeri mund te ndryshoje emertimin e saj, seline, te shtoje ortaket, te transferoje kuotat, te rrise kapitalin etj.. ne perputhje me ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar.

5.2 Shoqeria drejtohet sipas parimeve te ekonomise se tregut dhe ka qellime fitimi.

5.3 Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te kontrates se koncesionit, legjislacionit tregtar e atij civil ne fuqi.

5.4 Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit. Shoqeria ka vulen e saj .

KREU II

Kapitali

Neni 6

Kapitali themeltar

6.1 Kapitali themeltar i shoqerise eshte 10.000 lek. Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhteme:

Ortaku themelues "Arber Cela" zoteron nje kuote me vleren 10.000 LEK, e cila perben 100% te kapitalit themeltar.

6.2 Kontributi i ortakeve eshte ne para.Derdhja dhe transferimi i kapitalit te rregjistruar do te behet nga administrator I shoqerise I emeruar ne kete satatut

6.3 Ortaket jane pergjegjes kundrejt paleve te treta per humbjet qe peson Shoqeria, deri ne shumen e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.

6.4 Çdo kuote i jep zoteruesit te drejten e nje vote ne vleren e kuotes.

6.5 Kapitali themeltar mund te zmadhohet ose te zvogelohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore.

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

7.1 Kapitali themeltar mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar dhe / ose çdo forme tjeter te parashikuar nga ligji.

7.2 Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

7.3 Ne te gjithë rastet, zvogelimi i prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 8

Transferimi i kuotave

8.1 Kuotat e kapitalit te shoqerise dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre, mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise;
- d) dhurimit;
- e) çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

8.2 Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve pa kerkuar me pare miratimin e ortakeve te tjere. E vetmja procedure qe mund te zgjedhin te ndjekin ortaket, ne rastin e transferimit te kapitalit ndermjet ortakeve, eshte nenshkrimi i kontrates noteriale perkatese (shitblerjes, dhurimit etj.).

8.3 Perveç sa parashikohet ne piken 8.2, transferimi i kuotave ne persona te trete te ndryshem nga Ortaket, venia peng, barre apo çdo mjet tjeter sigurimi mbi kuotat, do te kerkoje, ne menyre

qe te prodhoje efekt, miratimin paraprak te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, e cila vendos me shumice te thjeshte.

8.4 Ne rastin kur nje Ortak ka per qellim te transferoje te gjithë apo nje pjese te kuotave te tij ne persona te trete te ndryshem nga Ortaket, ai, perpara se te nenshkruaje marreveshje me persona te trete, detyrohet te njoftoje me shkrim Administratorin per transferimin e planifikuar, duke percaktuar edhe çmimin e transferimit, personin/at te cileve planifikon t'u transferoje kuotat dhe kushtet esenciale te transferimit.

8.5 Administratori, brenda 10 diteve duke filluar nga dita qe ka marre dijeni per njoftimin per transferimin e planifikuar do te informoje me shkrim Ortaket e tjere.

8.6 Secili prej Ortakeve, brenda 1 (nje) muaji nga data e njoftimit nga Administratori per shitjen apo transferimin e planifikuar, detyrohet te njoftoje me shkrim Administratorin nese ka qellim te ushtroje te drejten e tij te parablerjes.

8.7 Administratori, brenda 10 (dhjete) diteve nga marrja e ketij njoftimi, do te njoftoje me shkrim Ortakun qe deshiron te transferoje kuotat e tij.

8.8 Nese me shume se nje Ortak ushtron te drejta e parablerjes, ata do te fitojne keto kuota ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre ne kohen e transferimit ne kapitalin themeltar.

8.9 Nese nje Ortak ka dhene njoftim per qellimin e tij per te ushtruar te drejten e parablerjes, ky Ortak do te kete te drejte te bleje kuotat objekt transferimi brenda 10 diteve nga data e mbarimit te afatit te percaktuar nga neni 8.6 me siper.

8.10 Vetem ne rast se te gjithë ortaket jane shprehur se nuk kerkojne te ushtrojne te drejten e parablerjes, atehere Ortaku qe ka per qellim te transferoje kuotat e tij do te jete i lire t'i transferoje keto kuota personit/ave te percaktuar ne njoftimin e tij.

8.11 Çdo transferim i kuotave qe nuk kryhet ne perputhje me parashikimet e ketij neni eshte i pavlefshem dhe pa efekte.

8.12 Transferimi i kuotave behet ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara ne kontraten e koncesionit.

Neni 9

Regjistri i Ortakeve

9.1 Pronesia mbi kuotat do te regjistrohet ne regjistrin e ortakeve qe do te mbahet ne seline e Shoqerise nen pergjegjesine e Administratorit ("Regjistri i Ortakeve").

9.2 Regjistri i Ortakeve do te pasqyroje informacionin e meposhtem: (i) identitetin e cdo Ortaku; (ii) numrin dhe vleren e kuotave qe i perkasin çdo Ortaku; (iii) daten e fitimit te pronesise se secilit Ortak mbi kuotat; (iv) adresen apo seline e cdo Ortaku; (v) detaje per cdo peng apo barre te vendosur mbi kuotat.

KREU III

Organet vendimarrëse dhe drejtuese

Neni 10

Organet e Shoqerise

Organet e shoqerise jane:

- Asambleja e Ortakeve;
- Administratori.

Neni 11

Organi vendimarrës

11.1 Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë e cila përfaqëson unanimitetin e Ortakeve.

11.2 Asambleja e Përgjithshme është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj të cilat janë të detyrueshme për të gjithë ortakët e shoqërisë edhe në rastin se ata mungojnë apo nuk shprehin votën e tyre pro apo kundër që nga dita që kanë marrë njoftimin sipas parashikimit në statut.

11.3 Asambleja e Përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimin e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabel të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç”, të kësaj pike;
- dh) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykate dhe procedimet e tëra ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblese;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar apo statuti;

11.4 Ortaku mund të përfaqësohet në asambletë të përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë në rastet e shoqërisë me disa ortakë; Autorizimi jepet në formë shkresore përherë dhe është i vlefshëm edhe për mbledhje të tjera me po këtë rend dite nëse nuk mbyllet po atë ditë me vendimarrje.

11.5 Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asambletë të përgjithshme.

11.6 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblese së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

11.7 Vendimet e Asambleja e Përgjithshme në mbledhje të zakonshme të saj janë të vlefshme kur miratohen nga një apo më shumë ortakë që përfaqësojnë shumicën e kapitalit themeltar.

11.8 Vendimet e Asambleja e Përgjithshme në mbledhje të jashtëzakonshme të saj janë të vlefshme vetëm kur miratohen nga një ose më shumë ortakë që përfaqësojnë të paktën 75% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

11.9 Asambleja e Përgjithshme miraton llogaritë dhe bilanci të Shoqërisë të komunikuar nga Administratori brenda gjashtë muajve nga mbyllja e vitit financiarë dhe vendos lidhur me ndarjen e fitimit në formën e dividendit.

Neni 12

Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme dhe thirrja e saj

12.1 Asambleja e Pergjithshme mblidhet sa here qe mbledhja eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise.

12.2 Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme thirret te pakten nje here ne vit.

12.3 Asambleja e Pergjithshme thirret nga administratoret apo ortaket te cilet perfaqesojne te pakten 10% te totalit te votave ne asamblene e pergjithshme te shoqerise.

12.4 Asambleja e Pergjithshme thirret nepermjet njoftimit me shkrese te derguar ne adresen postare te ortakeve ose nepermje postes elektronike si dhe nepermjet çdomjeti komunikimi elektronik i cili provon dergimin e njoftimit.

12.5 Njoftimi me shkrese apo nepermjet nje prej formave elektronike duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

12.6 Kur Asambleja e Pergjithshme nuk eshte thirrur si me siper, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsiive.

Neni 13

Korumi i nevojshem dhe vendim-marrja

13.1 Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 % te kuotave.

13.2 Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike.

13.3 Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se korumit te permendur me siper, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

13.4 Asambleja e pergjithshme vendos me tre te katertat e votave te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve dhe prishjen e shoqerise.

13.5 Per ceshtjet e tjera, asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres.

13.6 Ortakët, që nuk janë të pranishëm, kane mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi

Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:

- a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale;
- b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër;
- c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë se përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.

Neni 14

Përrjashtimi nga e drejta e votës

14.1 Ortaku nuk mund të ushtroj të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendimin për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

14.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 15

Procesverbali i mbledhjes së asamblese

15.1 Te gjitha vendimet e Asamblese së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal.

15.2 Administratori përgjigjet për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblese së përgjithshme.

15.3 Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e mbajtësit të procesverbalit dhe rezultatet e votimit. Procesverbalit i bashkelidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si, akti i thirrjes së asamblese së përgjithshme dhe njoftimet dhe letermarrjet/konfirmimet e ortakeve.

15.4 Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga anëtarët pjesëmarrës dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

Neni 16

Administrimi

16.1 Asambleja e Përgjithshme emeron administrator të shoqërisë z.Hekuran Alizoti , i biri i Fehmiut, i datelindjes 20.11.1957, lindur në Lushnje dhe banues në Lushnje madhor dhe me zotesi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me ID F71120163D.

16.2 Afati i emerimit është 5 vjet, nga data 10.09.2024 deri me datën 10.09.2029 me të drejtë rimerimi .

16.3 Në rast se gjatë kësaj periudhe shfaqen probleme paaftësie nga ana e tij, Asambleja e Përgjithshme vendos shkarkimin e administratorit duke treguar me fakte demin që i është shkaktuar shoqërisë nga paaftësia e tij pasi është dhënë mendimi për këto dem edhe nga specialistët përkatës.

16.4 Emerimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

16.5 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për fajet kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

16.6 Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Përgjithshme, që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

16.7 Kompetencat dhe përgjegjësitë e administratorit janë:

- a) ka liri të plotë dhe të pakufizuar për drejtimin e zakonshëm të shoqërisë, ka të gjitha kompetencat për të vepruar me të tretet në emër të shoqërisë dhe në interes të saj, në të gjitha

rrethanat, me përjashtim të kompetencave që ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar dhe Statuti i shoqërisë, si më sipër, ua jep shprehimisht ortakeve.

b) ka të drejtë të nënshkruajë kontrata të ndryshme shërbimi, porosie, furnizime publike private si dhe çdo kontratë tjetër të nevojshme që ka për qëllim dhe është në funksion të realizimit të të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata e Koncesionit.

c) Administratori ka të drejtë të nënshkruajë kontrata me studio ligjore, të ndermarre veprime gjyqësore në emer dhe për llogari të shoqërisë, etj. Administratori mund të japë prokurë në kufijte që i lejon Asambleja e Ortakeve për kategori të caktuara veprimesh. Përfaqësimi ligjor i shoqërisë është i vlefshëm për çdo veprim gjyqësor apo jashtëgjyqësor.

d) Administratori është i detyruar të mbajë konform ligjit të gjitha regjistrat e domosdoshme për aktivitetin e shoqërisë. Administratori i shoqërisë është i detyruar të mbajë inventare të rregullta. Raporti i administrimit, inventari dhe llogaritë vjetore, hartohen nga Administratori.

e) Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim apo mosveprim që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse veprimi apo mosveprimi është kryer në mirëbesim.

f) Administratori është përgjegjës për administrimin e shoqërisë dhe informon periodikisht ortakët për ecurinë e veprimtarisë tregtare të shoqërisë. Gjatë veprimtarisë së tij ai vepron duke marrë parasysh interesat e shoqërisë, duke zbatuar parimet e detyrimit të besnikërisë.

g) të tjera të parashikuara me ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar.

Neni 17

Konfidencialiteti

Veprimtaria e shoqërisë dhe marrëdhëniet e punës me punonjësit e saj bazohen në respektimin e detyrimit të ruajtjes së konfidencialitetit.

Neni 18

Të drejtat e lidhura me kuotën

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

KREU IV

VITI FINANCIAR – EKSPERTËT

Neni 19

Viti financiar dhe dividenti

Viti financiar i shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 20

Ekspertet

20.1 Kontrolli mbi veprimtarine e Administratorit si dhe mbi gjithe aktivitetin e shoqerise i besohet nje eksperti kontabel i cili emerohet nga Asambleja e Pergjithshme. Kohezgjatja e veprimtarise se ekspertit dhe shperblimi caktohen me vendim te Asamblese se Pergjithshme.

20.2 Eksperti, ne fund te periudhes se kontrollit, harton raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar dhe detyrohet t'ua dorezoje te gjithe ortakeve.

Neni 21

Bilanci dhe dividenti

Veprimtaria ekonomike e shoqerise do te mbyllet ne dt. 31 Dhjetor te cdo viti. Administratori merr masa per hartimin e bilancit dhe rezultatit ekonomik fitim - humbje dhe inventar. Pasi vecohen fondet si me siper dhe paguhen detyrimet fiskale, te ardhurat qe mbeten ndahen midis ortakeve dhe mund te transferohen lirisht jashte Republikes se Shqiperise sipas dispozitave perkatese ligjore.

Neni 22

Shperndarja dhe likuidimi i Shoqerise

22.1 Shoqeria prishet:

(i) me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve; ose

(ii) ne rast falimentimi; ose

(iii) kur Shoqeria nuk ka kryer veprimtari per 2 (dy) vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne QKR; ose

(iv) me vendim gjykate; ose

(v) per arsye te tjera te parashikuara ne ligj.

22.2 Prishja e shoqerise regjistrohet ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit nga Administratori.

22.3 Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga asambleja e pergjithshme. Nese asambleja e pergjithshme nuk merr nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

22.4 Cdo person i interesuar, ka te drejte t'i kerkoje gjykates zevendesimin e likuiduesit, sipas vendimit te ortakeve, nese paraqet arsye te mjaftueshme per te dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqerise mund te cenohet nga likuiduesit e emeruar si me siper. Kerkesa duhet te depozitohet ne gjykate brenda 30 diteve nga data e caktimit te likuiduesit.

22.5 Gjykata emerone likuiduesin, ne rastet kur shoqeria tregtare prishet me vendim gjykate. Likuiduesit shkarkohen dhe zevendesohen me te njejtat kushte, te parashikuara ne dispozitat per emerimin e tyre.

22.6 Administratoret e shoqerise i njoftojne per regjistrim, Qendres Kombetare te Regjistrimit te dhenat e likuiduesve te pare dhe tagrat e tyre, per te perfaqesuar shoqerine, se bashku me dokumentet perkatese. Likuiduesit depozitojne nenshkrimin e tyre.

22.7 Likuiduesit i njoftojne, gjithashtu, Qendres Kombetare te Regjistrimit per regjistrim gdo ndryshim per identitetin dhe tagrat e tyre te perfaqesimit.

22.8 Likuiduesit duhet te ftojne kreditorët e shoqerise per te depozituar pretendimet e tyre per prishjen e saj. Likuiduesi merr persiper te drejtat dhe detyrimet e administratoreve nga data e emerimit te tij.

Neni 23

Librat e shoqerise

Shoqeria ne baze te ligjit mban:

- 1) Librin e Ortakeve
- 2) Librin e Mbledhjeve
- 3) Librin e vendimeve te organit administrativ
- 4) Librin e mbledhjeve dhe vendimeve te eksperteve.

Librat e mesiperm duhet te jene te ruajtura per 10 vjet e cdo faqe duhet te jete e vulosur.

Neni 24

Riorganizimi i shoqërisë, bashkimi, ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas vendimit të Mbledhjes të Asamblesë së Pergjithshme, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në pjesën e IX të Ligjit 9901 date 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 25

Norma referuese

25.1 Persa nuk parashikohet ne kete statut do te behet referimi ne ligjet e miratuara dhe ato ne fuqi ne republiken e Shqiperise ne fushen e shoqerive tregtare.

25.2 Autoritetet Gjyqesore Shqiptare jane ato te cilat kane kompetencen ekskluzive per zgjidhjen e te gjitha mosmarreshjeve qe mund te lindin midis ortakve apo midis tyre dhe Organeve te shoqerise.

Neni 26

Dispozita te pergjithshme

Persa eshte shprehur ne kete statut i referohemi Ligjit nr. 9901 dt 14.04.2008 “Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar dhe Kontrates se Koncesionit.

Cdo ndryshim behet ne te njejten menyre sic eshte nxjerre ky Statut dhe nuk prek personalitetin juridik te kesaj shoqerie.

Ky Statut hyn ne fuqi pas miratimit dhe regjistrimit te Shoqerise ne regjistrin tregtar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

Gjithçka nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut do të rregullohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje të tjera të lidhura me të në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Ky Statut përpilohet në 5 (pese) kopje në gjuhën shqip me të njëjten vlerë, dhe nënshkruhet pa vërejtje nga ortaket themelues.

ORTAKET E SHOQERISE

Arber CELA

